



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.509/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Ferit Osmani dhe Vllastimir Dimiq, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Adnan Jupolli kryesues i vendvotimit 1923E/01R për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Fryma e Re (FER).

ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik FER në të cilën theksohet se me datën 12.12.2010 rreth orës 10:30 vëzhguesi i FER-it në QV shkolla e mesme ekonomike Hoxh Kadri Prishtina 1923E/01R, Dardan Misini ka raportuar se në shkollë nuk kanë punuar aparatet për identifikim. Vëzhguesi i FER-it i ka raportuar Adnan Jupollit i cili nuk ka ndërmarë asgjë.

Parashtruesi i ankesës thekson se pas gjysmë ore aparatet janë rregulluar.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë prove materiale.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshtë:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

PZAP-i vlerëson se ankesa e FER-it paraqitur kundër kryesuesit të vendotimit është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshire edhe rregullimin e aparateve për identifikim fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura me lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa

A nr. 509/2010 më datën 14.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

